

# Përfundoi kampionati i Ligës Shqiptare të Futbollit në Austri

27.09.2013 - 10:51

**Kampione shpallet klubi futbollistik “FC MEGI” “...Ne do ju mbështesim vazhdimisht dhe e vlerësojmë punën tuaj të madhe”.**



prevnext

2

Në një ambient të shkëlqyeshëm dhe mot të mirë u zhvillua rundi i fundit i garave në Ligën Shqiptare të Futbollit të Austrisë. Kjo ishte edhe dita kulmore kur ndahen kupa, medalje, falënderime për të gjithë ata që ndihmuan në mbarëvajtjen e kampionatit. Nuk ishte i pakët vargu i atyre që sot u stolisën me ndonjë nga simbolet e sportit më të popullarizuar në glob, futbollit. Garat përfunduan solemnisht nga kryetari i LSHFA, z.Qani Sylejmani. Ai përshëndeti të pranishmit dhe falënderoj të gjithë ata që ndihmuan mbarëvajtjen e ligës, sponsoret e zellshëm, pa të cilët nuk do kishim as kampionat. LSHF në Austri vazhdimisht e kanë mbështetur edhe ambasadorët e Shqipërisë dhe Kosovës. I pari i diplomacisë nga Kosova në Austri, Shkëlqesia e Tij Dr. Sabri Kiqmari, ambasador i cili përshëndeti të pranishmit, lojtarët

dhe udhëheqësit e LSHF në Austri. “E ndiej veten krenar me punën e mirë që mërgimtarë bëjnë, njëra nga ato është puna e LSHF në Austri. Garat që ju zhvilloni, qëndrimi, kultura e treguar janë me rëndësi në jetën tonë, imazhin tonë këtu në Austri. Ne do ju mbështesim vazhdimisht dhe e vlerësojmë punën tuaj të madhe”. Ishte prezent edhe z. Imer .Lladrovci, konsull i sapo emëruar në Austri, ishin edhe përfaqësues nga mediat, z.Demir Reshiti nga RTK- dhe përfaqësuesit e TV- Hana nga Kumanova.

Moti ideal ndikoj në nivelin e lartë të garave ku fituese e gjithë kampionatit doli “FC-MEGI” me 41 pikë të tubuar në renditjen përfundimtare në tabelën e kampionatit. Në vendin e dyte renditet “FC.TIMI” me 35 pike, kurse me 32 pikë vendi i tretë i takoi “FC.SHQIPONJA” ,duke vazhduar: “FC A.ZHITIA” 29 pikë, “BISH” 28; “KF-STRUGA” 21, “FC-SHARRI” 8, “FC-VËLLAZNIMI” 6, dhe e fundit “L. E MALËSISË” me 6 pikë. Kupën e lojtarit më të mirë të kampionatit e mori futbollisti Bujar Demaku (FC-Megi), kurse golashënuesi më i mirë u shpall Enes Rexhepi (FC-Timi), portieri më i mirë Ilir Sulejmani (FC-Timi). Po ashtu me kupë u nderuar ekipi më i disiplinuar “FC-BISH” ndërsa trajneri më i mirë u shpall Nexhbedin Lleshi (FC-A.Zhitia). Ai i cili dha shumë me aktivitetin e tij ishte z.Mexhid Bislimi nga FC-Timi i cili u shpall edhe Aktivisti i Kampionatit. Ndarjet e kupave dhe medaljeve u shoqëruan me vallet e ekzekutuara nga shoqëria kulturo-artistike “12 Qershori”. Veçan atmosferën e ngrohu vallja shqiptare “Shota” e luajtur nga valltarët e valltares entuziast nën drejtimin e koreografes Rolanda Limani.

Moderimin e rrjedhës së pjesës solemne e bëri z.Salih Januzaj. Ai njëherit është kandidat në zgjedhjet austriake pas një jave, nga radhët e shqiptarëve. Ai është kandidat i Partisë Socialdemokrate e Austrisë(SPÖ). U kërkua nga të pranishmit që kanë të drejtë vote ta shkruajnë emrin Saliuka në rendin e SPÖ në fletëvotim.

Në mesin e spektatorëve kishin ardhur edhe shumë figura arti, kulture, shkence nga radhët e mërgimtarëve. Dr. Alim Arnauti, një veprimtar i njohur shqiptar nga Kosova i shpërngulur në Siri i cili jeton në Vjenë. Xhevat Bala, drejtor i “Albacopy” i njohur si veprimtar i devotshëm. Dr.Ina Arapi, studiuese pranë Institutit të Europës Lindore dhe aktiviste në Institutin Kulturor “Aleksandër Moisiu” në Vjenë. Osman Ademi, kryetar i Shoqatës së Mësuesve dhe Prindërve Shqiptarë në Austri. Ishte një ditë takimi e loje e rinisë shqiptare e cila ka nevojë për argëtim e edukim me fjalën dhe qëndrimin në virtytet kombëtare.

